



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 mars 2020
Nr. ref.:RK 1536/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI83/19

Parashtrues

Nikolaj Skljarenko

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-222/2015,
të 20 shtatorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Nikolaj Skljarenko me vendbanim në Beograd, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij ka bashkangjitur një autorizim me të cilin e autorizon OJQ-në "Justicia" nga Prishtina, përkatësisht zyrtaren e saj Flutura Xharra, që në emër dhe llogari të tij të dorëzoj kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), dhe gjithashtu të pranojë letra në emër dhe llogari të tij.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [GSK-KPA-A-222/2015] të 20 shtatorit 2018 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Vendimin [KPCC/D/R/231/2014] e 13 marsit 2014 i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP).
3. Parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin [GSK-KPA-A-222/2015] e 20 shtatorit 2018 të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 12 shkurt 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit, parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me (i) nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ); (ii) nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Mbrotjtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KENDJ); dhe (iii) nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) e 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 maj 2019, parashtruesi i kërkesës përmes postës parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Kërkesën e tij Gjykata e pranoi më 27 maj 2019.
7. Më 29 maj 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 19 qershor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në po të njëjtën datë, Gjykata njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo të dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën që

dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar [GSK-KPA-A-222/2015] të 20 shtatorit 2018.

9. Më 28 qershor 2019, Gjykata Supreme dorëzoi kopjen e fletëkthesës që dëshmon se parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 12 shkurt 2019.
10. Më 19 dhjetor 2019, Gjykata kërkoj nga Gjykata Supreme dosjen origjinale të rastit.
11. Më 24 dhjetor 2019, Gjykata Supreme dërgoi dosjen origjinale të rastit me disa nga shkresat përkatëse.
12. Më 11 mars 2020, Gjykata shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 2 nëntor 1998, parashtruesi i kërkesës dhe B.K nënshkruan Kontratën mbi Shit-Blerjen e Paluajtshmërisë (në tekstin e mëtejme: Kontrata) dhe e cila, bazuar në shkresat në lëndës, nuk ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale). Bazuar në këtë Kontratë, prona e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht *“shtëpia me oborr e cila gjendet në Prishtinë, rr. E Pejës nr. 5 dhe e cila është e regjistruar në listën poseduese Pl.nr.3053 KK Prishtinë si parcelë e kategorisë nr. 6553 nga e cila si shtëpi janë 0.00,75 ha dhe si oborr 0.00,69 ha”*, iu shit B.K-së në vlerën prej 110,000 marka gjermane.
14. Më 28 gusht 2006, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar një ankesë në AKP, duke kërkuar të drejtën në pronësi në parcelën kadastrale nr.6553, me sipërfaqe të përgjithshme prej 0.01.44 ha, në zonën kadastrale në Prishtinë. Në ankesën e tij parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar se humbja e posedimit mbi këtë pronë kishte ndodhur në muajin gusht të vitit 1999, si rezultat i rrethanave politike përgjatë viteve 1998/1999 në Kosovë. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës ankesës së tij ia kishte bashkangjitur shkresat si në vijim: (i) kopjen e planit të 7 janarit 1989 të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Komunës së Prishtinës, në të cilën parcela e tokës ndërtuese nr.6553 është regjistruar në emër të parashtruesit të kërkesës; (ii) Aktvendimin [07 nr. 361-235/89] e 18 majit 1990 të Sekretariatit për Urbanizëm të Komunës së Prishtinës, mbi lejimin e shndërrimit të një pjese të ndërtesës së banimit në ambient për punë; (iii) letërnjoftimin e 20 prillit 2001, të lëshuar nga ana e organeve paralele të Komunës së Prishtinës në emër të parashtruesit të kërkesës; (iv) përgjigjen e parashtruesit të kërkesës në lidhje me kërkesat e palës tjetër të 7 dhjetorit 2001, përmes të cilës ai sqaron se e ka dhënë autorizimin dhe ka shitur pronën, por që këtë e ka bërë nën kërcënim dhe nën presion të situatës politike, si pasojë e të cilës, është detyruar të shesë pronën me çmim i cili ka qenë më i vogël se çmimi real i tregut.
15. Bazuar në shkresat e lëndës, më 21 gusht 2007 dhe 23 prill 2010, Sekretari Ekzekutiv i AKP-së, kishte kryer identifikimin e pronës dhe kishte konstatuar

se prona përkatëse ka qenë e zënë dhe në përdorim të personave të panjohur. Po ashtu, sipas shkresave të lëndës, personi S.T, ka deklaruar që e ka blerë pronën në fjalë.

16. Bazuar në shkresat e lëndës gjithashtu rezulton se më 12 maj 2010, personi B.K i kishte dorëzuar Sekretariatit të AKP-së dokumentet përmes të cilave kishte pretenduar pronësinë e pronës kontestuese, si në vijim: (i) para-kontratën e 2 nëntorit 1998 të nënshkruar në mes të parashtruesit të kërkesës dhe personit B.K, por e cila nuk ishte e vërtetuar në gjykatë; (ii) deklaratën me numër [8321/99] të 19 tetorit 1999, të vërtetuar në gjykatë në Beograd, përmes të cilës bashkëshortja dhe djali i parashtruesit të kërkesës deklarojnë që janë në pajtim që prona përkatëse është shitur dhe që nuk do të kërkojnë pavlefshmërinë e Kontratës së shitblerjes, madje edhe nëse është shitur nën çmimin që përbën dëm i cili është më i madh se gjysma ose me çfarëdo baze tjetër të kontestojnë blerësin e ri, respektivisht, personin B.K.; (iii) autorizimin [II nr. 8349/99] e 4 nëntorit 1999 të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Beograd, të dhënë nga ana e parashtruesit të kërkesës për personin N.V, autorizim ky i pakufizuar për shitjen dhe bartjen e pronës së kërkuar; (iv) Kontratën e shitblerjes [575/2002] të 4 majit 2002, të vërtetuar në Gjykatën Komunale e të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës dhe personi B.K; (v) specifikimin e parave-kartëmonedhave të cilat personi B.K i ka dorëzuar parashtruesit të kërkesës; (vi) listën poseduese të 14 gushtit 2007 të lëshuar nga ana e administratës të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, përmes të cilës rezulton se parcela nr. 6553 është e regjistruar në emër të personit B.K; dhe (vii) vërtetimin mbi pronësinë e 11 gushtit 2009, me të cilën dëshmohet që prona e kërkuar është e regjistruar në emër të personit B.K.
17. Më 13 mars 2014, KKPK, përmes Vendimit grupor [KPCC/D/R/231/2014], vendosi të hedh poshtë kërkesën nr.13321, përkatësisht atë të parashtruesit të kërkesës nën titullin e Vendimit *“III. Tjetërsimi vullnetar para konfliktit”*, duke arsyetuar se kërkesa përkatëse është parashtruar nga ana e parashtruesit të kërkesës në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të të drejtave pronësore. KKPK arsyetoi se përmes kësaj kërkesë parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se ka humbur posedimin e tij mbi pronat për shkak të rrethanave gjatë viteve 1998-1999, por më vonë ka lajmëruar Sekretariatin Ekzekutiv të AKP-së që prona në fjalë është shitur me vullnetin e tyre. Andaj, duke marrë parasysh që nuk ka ekzistuar asnjë e drejtë pronësore mbi pronën para ose pas konfliktit, përkatësisht ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, periudhë kohore kjo nën mandatin e KKPK-së, kjo kërkesë u refuzua. KKPK, në arsyet e marrjes së këtij Vendimit gjithashtu u referua në paragrafin 1 të neni 3 (Përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Pronës) të Rregullores 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (në tekstin e mëtejme: Rregullorja nr. 2006/50) e ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079 për ndryshimin e Rregullores nr. 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (në tekstin e mëtejme: Ligji nr.03/L-079), ndërsa specifikisht lidhur me kërkesat e refuzuara, u referua në paragrafin 6 të nenit 8 (Vendimet e Komisionit) të Aneksit III të Udhëzimit Administrativ nr.2007/5 për implementimin e Rregullores nr. 2006/50 (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Administrativ nr. 2007/5).

18. Më 14 janar 2015, parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën Supreme kundër Vendimit [KPCC/D/R/231/2014] të 13 marsit 2014, duke pretenduar vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij theksoi se (i) KKPK nuk ka vërtetuar drejt faktet e rastit sepse ai asnjëherë nuk ka deklaruar se pronën e ka shitur me vullnet të lirë; (ii) dokumentet e paraqitura dëshmojnë se prona është shitur nën presion dhe kërcënim për shkak të rrethanave përgjatë viteve 1998-1999; dhe (iii) Kontrata e cila nuk është vërtetuar në gjykatë, është nënshkruar nën presion në nëntor të vitit 1999; por se personi B.K e ka detyruar atë që në Kontratë të shënoj datën 2 nëntor 1998. Sipas parashtruesit të kërkesës kjo vërtetohet me faktin se autorizimi për I.N përkitazi me pronën e kontestuar është bërë më 2 nëntor 1999, autorizim ky i cili gjithashtu është bërë nën presion dhe kërcënim. Parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij gjithashtu kërkoi nga Gjykata Supreme: (i) dëgjimin e dy dëshmitarëve; dhe (ii) përcaktimin e një eksperti financiar për shkak të mos-përputhjes së vlerës së tregut të pronës me çmimin e paguar. Duke u referuar në nenin 4 (Kërcënimi) të Udhëzimit Administrativ nr. 2007/5 dhe duke arsyetuar se Kontrata është nënshkruar nën kërcënim, parashtruesi i kërkesës propozon që Kontrata të shpallet e pavlefshme, kompetencë kjo e përcaktuar për KKPM-në bazuar në këtë nen.
19. Më 20 shtator 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [GSK-KPA-A-222/2015], hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe rrjedhimisht vërtetoi Vendimin [KPCC/D/R/231/2014] e 13 marsit 2014 të KKPK-së përkitazi me kërkesën nr. 13321.
20. Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj të lartcekur, ndër të tjera sqaroi se (i) pala ankuese, përkatësisht parashtruesi i kërkesës *“nuk ia ka dalë të dëshmojë pronësinë ose ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar, mu para ose gjatë periudhës 1998-1999, siç është paraparë në nenin 3.1 të Rregullores nr. 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079”*; (ii) Komision me të drejtë ka hedhur poshtë kërkesën bazuar në pikën b) të paragrafit 4 të nenit 11 (Procedura dhe vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore) të Ligjit nr. 03/L-079, sepse është vërtetuar që humbja e posedimit nuk është pasojë e konfliktit, ndërsa bazuar në paragrafin 1 të nenit 3 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK ka kompetencë mbi kërkesat për pasurinë private të paluajtshme atëherë kur humbja e pronësisë ndërlidhet me rrethanat e konfliktit të ndodhur në mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999; dhe (iii) provat dhe shkresat e lëndës nuk mbështesin argumentet se shitblerja mund të ketë qenë rezultat i kërcënimit siç është definuar në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr.2007/5.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me (i) nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (ii) nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin

1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KENDJ-së; dhe (iii) nenet 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) e 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KENDJ-së.

22. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KENDJ-së, parashtuesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës së tij në vendim të arsyetuar gjyqësor. Më saktësisht, parashtuesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme vetëm ka konfirmuar Vendimin e KKPK-së dhe i cili *“në një paragraf të shkurtër ka dhënë arsyetimin për vendimin në një mosmarrëveshje ligjore shume komplekse”*.
23. Për më tepër, parashtuesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Gjykata Supreme dhe KKPK-në, kanë dështuar të vërtetojnë drejt faktet e rastit, përfshirë faktin vendimtar, që Kontrata e shitblerjes është nënshkruar nën kërcënim. Në këtë kontekst, parashtuesi i kërkesës pretendon se bazuar në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 2007/5, KKPK ka qenë e detyruar që të shpall të pavlefshme Kontratën për shit-blerjen e pronës kontestuese sepse e njëjta është bërë nën kërcënim. Në këtë aspekt, parashtuesi i kërkesës, ashtu siç kishte pretenduar edhe në ankesën fillestare para KKPK-së edhe përmes ankesës në Gjykatë Supreme, thekson se (i) Kontrata e shitblerjes, është nënshkruar në nëntor 1999, por se B.K e ka detyruar që në Kontratë të shënoj datën 2 nëntor 1998; (ii) këtë Kontratë e ka nënshkruar nën kërcënim, ashtu siç e ka nënshkruar edhe autorizimin për personin N.V më 4 nëntor 1999; dhe (iii) çmimi me të cilën është shitur prona nuk është në përputhje me vlerën e tregut të tij, fakt ky i cili bazuar në paragrafin 3 të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr.2007/5, përcakton që derisa të jetë vërtetuar vlefshmëria e një kontrate, kërcënimi duhet të supozohet.
24. Në fund, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata *“[...]të anulojë kontratën e pretenduar në fjalë mbi shitblerjen ose të më paguhet kompensimi në lartësi të vlerës së tregut të pronës”*.

Dispozitat Relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1.Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2.Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

*1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]*

Rregullore nr. 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale i ndryshuar me Ligjin nr. 03/l-079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale

Neni 3 Përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Pronës

3.1 Agjencia Kosovare e Pronës përmes Sekretarisë ekzekutive ka kompetenca për të pranuar dhe për të regjistruar dhe, përmes Komisionit për kërkesa pronësore ka kompetenca për t'i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:

(a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe

(b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore.

3.2 Asgjë në këtë nen nuk i cenon të drejtat e paditësve që të ndjekin pranë gjykatave kompetente kërkesat që nuk përfshihen në kërkesat e paraqitura në nenin 3.1.

[...]

Urdhëresë Administrative nr. 2007/5 për Implementimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale, i ndryshuar me Ligjin nr. 03/l-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale

Neni 4 Kërcënimi

4.1 Çdo kontratë që pretendon heqjen dorë nga e drejta pronësore mbi pronën e paluajtshme private, e lidhur nën kërcënim Komisioni mund ta shpall të pavlefshme, së bashku me çfarëdo shitje pasuese të pronës.

4.2 Kërcënimi është i pranishëm në rastet kur shitësi në kohën e lidhjes së kontratës ose:

(a) Ka qenë apo i është nënshtruar dhunës, frikësimit apo kërcënimeve fizike; ose

(b) Në bazë të fjalëve apo mirësjelljes së drejtuar personalisht atij apo asaj nga çdo person, frikës së arsyeshme të dhunës së pashmangshme apo lëndimit fizik të vet tij/saj, apo anëtarëve të familjes së tij/saj.

4.3 Kërcënimi supozohet, derisa të jetë dëshmuar vlefshmëria e kontratës, ku vlera e tregut e pronës në kohën e shitjes nuk paraqet lidhje të arsyeshme me çmimin real blerës të paguar.

4.4 Vendimi në bazë të nenit 2.1 që e shpall kontratën të pavlefshme do të përfundojë përgjithmonë nëse shitësi nuk ia paguan Sekretarisë ekzekutive, si agjent i blerësit, shumën e çmimit të shitblerjes në tërësi, së bashku me shumën e përcaktuar të kamatës së mbetur, brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së njoftimit mbi vendimin.

[...]

ANEKSI III Detyrat, përgjegjësitë dhe rregullat e procedurës të Komisionit për Kërkesa Pronësore

Neni 8 Vendimet e Komisionit

8.6 Në vendimin e tij, Komisioni mund:

(a) të vendosë mbi të drejtat pronësore të kërkuara që janë të nevojshme për zgjidhjen e kërkesës;

(b) të lëshojë urdhër për posedim të pronës në dobi të cilësdo pale;

(c)refuzojë apo hedh poshtë kërkesën bazuar në çfarëdo arsye, përfshirë edhe ato të cekura në nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50;
(d)të anulojë çfarëdo marrëveshje lidhur me pronën e cila është objekt e urdhërit në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 si dhe të lëshojë urdhëra shtesë për ta futur në fuqi anulimin.
(e)të marrë çfarëdo vendimi apo urdhëri të nevojshëm për t'i futur në fuqi dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 apo kësaj Urdhërese Administrative.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa Individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

28. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [GSK-KPA-A-222/2015] e 20 shtatorit 2018 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
29. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i Rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

30. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës, pretendon që në nëntor të vitit 1999 kishte nënshkruar autorizimin për N.V dhe Kontratën e shitblerjes me B.K lidhur me pronën e kontestuar, nën kërcënim dhe nën presionin e rrethanave politike të krijuara në Kosovë në vitet 1998-1999. Nga shkresat e lëndës rezulton se një autorizim tjetër ishte nënshkruar më 4 nëntor 1999 për personin N.V, ndërsa edhe një Kontratë e shit-blerjes për pronën kontestuese ishte nënshkruar më 4 maj 2002 dhe e njëjta ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale.
31. Parashtruesi i kërkesës në vitin 2006 i kishte filluar procedurat duke kërkuar që Kontrata e vitit 1999 të shpallet e pavlefshme, duke u ankuar fillimisht në KKPK, me pretendimin se humbja e posedimit mbi këtë pronë kishte ndodhur në muajin gusht të vitit 1999 si rezultat i rrethanave gjatë viteve 1998/1999 në Kosovë. KKPK refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës përmes Vendimit i cili më pas u vërtetua nga Gjykata Supreme. Të dy vendimet, Vendimi [KPCC/D/R/231/2014] i 13 marsit 2014 i KKPK-së dhe Aktgjykimi [GSK-KPA-A-222/2015] i 20 shtator 2018 i Gjykatës Supreme, kishin konstatuar se parashtruesi i kërkesës (i) nuk ka arritur të dëshmoj se mban pronësinë mbi pronën e kontestuar; (ii) që rrethanat e tjetërsimit të pronës së tij nuk ndërliiden me rrethanat e krijuara në Kosovë në vitet 1998-1999 dhe rrjedhimisht, nuk hyjnë në kuadër të periudhës së përcaktuar në kompetencë të KKPK-së bazuar në ligjin e aplikueshëm; dhe për më tepër (iii) se dëshmitë e rastit nuk mbështesin mundësinë që Kontrata të jetë lidhur nën kërcënim. Parashtruesi i kërkesës konteston këto konstatime para Gjykatës, duke

pretentuar, në esencë, shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mos arsyetimit të Vendimit të KKPK-së dhe atij të Gjykatës Supreme si dhe shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1. lidhur me të drejtat e tij pronësore.

32. Gjykata në vijim do t'i trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesë lidhur me (i) shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mos-arsyetimit të vendimeve gjyqësore; dhe (ii) shkeljet e pretenduara të neneve 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KENDJ-së; dhe nenet 8 e 14 të KEDNJ-së, duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
- (i) *Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KENDJ-së lidhur me mos-arsyetimin e vendimit gjyqësor*
33. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës së tij në vendim të arsyetuar gjyqësor, duke theksuar se Gjykata Supreme dhe KKPK, kanë dështuar të arsyetojnë vendimet e tyre por edhe të vërtetojnë drejt gjendjen faktike.
34. Gjykata në këtë aspekt, fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.
35. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues "IKK Classic", Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; dhe KI49/19, parashtrues *Limak Kosovo International Airport S.H.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim për Papranueshmëri i 10 shtatorit 2019, paragrafi 37).
36. Në parim, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të

arsyetuar dhe se gjykatat duhet “të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre”. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm. (Shih rastin e Gjykatës KI49/19, cituar më lart, paragrafi 38).

37. Duke u bazuar në sa më sipër, Gjykata thekson se KKPK kishte nxjerrë një Vendim grupor përmes të cilit lidhur me rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës kishte konstatuar se (i) ai është paraqitur në cilësinë e mbajtësit të pretenduar të drejtave pronësore; (ii) bazuar në deklaratat e tij të dhëna para Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, prona kontestuese ishte shitur me vullnet të lirë; dhe (iii) nuk ka ekzistuar asnjë e drejtë pronësore mbi pronën para ose pas konfliktit 1998-1999. Konkretisht, KKPK kishte arsyetuar si në vijim:

“90.Kërkesat me numër 13321 dhe 45334, të listuar në pjesën D të bashkëngjitjes, janë parashtruar nga ana e parashtruesit të kërkesës në cilësinë e tij ose saj të bartësve të pretenduar të të drejtave pronësore ose sipas rastit, në cilësinë e anëtarit të familjes së mikpritësit të shtëpisë të bartësve të pretenduar të të drejtave të pronësisë. Në secilën nga këto kërkesa, parashtruesit e kërkesave fillimisht kanë pretenduar që ata ose familjet e tyre kanë humbur posedimin mbi pronat në fjalë për shkak të konfliktit të 1998-1999. Megjithatë, parashtruesit e kërkesave më vonë kanë lajmëruar sekretariatit ekzekutiv që ata ose familjet e tyre, me vullnet të tyre, para konfliktit të 1998-1999, kanë shitur pronën në fjalë. Nën këto rrethana, ku ka vërtetuar parashtruesi i kërkesës që nuk ka pasur kurrfarë të drejte pronësore mbi pronën në fjalë para ose pas konfliktit të vitit 1998-1999, kërkesat për këtë arsye refuzohen.”

38. Gjykata vëren se përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me mos-arsyetimin e vendimit gjyqësor, nuk qëndron pohimi se Gjykata Supreme ka nxjerrë një vendim i cili vetëm ka mbështetur vendimin e KKPK-së. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, kishte shpallur ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pranueshme dhe kishte shqyrtuar meritat e rastit, duke u fokusuar në pretendimet thelbësore të tij, përkatësisht (i) mungesën e kompetencës së KKPK lidhur me kërkesat për pasurinë që nuk ndërlidhen me rrethanat e konfliktit, përkatësisht periudhën kohore ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershor 1999 të përcaktuar përmes ligjit të aplikueshëm; dhe (ii) pretendimet e parashtruesit të kërkesës që Kontrata është nënshkruar nën kërcënim.
39. Përkitazi me çështjen e parë, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj, kishte theksuar si në vijim:

“20.Në bazë të nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë mbi kërkesat për pasurinë private të paluajtshme dhe të drejtë për përdorimin e pasurisë private “humbja e pronësisë së cilës është drejtpërdrejt në lidhje me pasojat e konfliktit të armatosur ose rrethanat në lidhje me konfliktin i

cili ka ndodhur në mes të 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999". Pasi që Komisioni ka vërtetuar që humbja e posedimit nuk është pasojë e konfliktit, ai ka hedhur poshtë kërkesën në bazë të nenit 11.4 (b) të Ligjit nr. 03/L-079."

40. Ndërsa, përkitazi me çështjen e dytë, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit të saj, kishte theksuar si në vijim:

"17.Megjithatë, sa i përket pretendimit të parashtruesit të ankesës në ankesën e tij që ai nuk ka lidhur kontratën e shit blerjes me vullnetin e tij të lirë, pasi që pala përgjegjëse ka bërë presion dhe e ka detyruar të kryejë transaksionin, Gjykata Supreme konkludon që kontrata e kërkuar në mes të palës ankuese dhe palës përgjegjëse në ankesë është lidhur pa bërjen e presionit ose dhunës. Krahës kësaj, autorizimi i dhënë është vërtetuar në gjykatë në Beograd.

18.Autorizimi i 2 nëntor 1999, i vërtetuar në Gjykatën komunale në Beograd, Serbi, i cili i është dhënë palës tjetër, ka fuqi të plotë të veprimit "të shesë, marrë çmimin e blerjes dhe ta transferojë në persona tjerë" dhe si i tillë është argument shtesë që pala ankuese e ka shitur pronën e kërkuar në bazë të vullnetit të lirë.

[...]

20.Prandaj Komisioni ka vepruar drejtë kur ke hedhur kërkesën por lëndën nuk e ka kuptuar rastin si res judicata dhe të hedhë kërkesën, sepse duhet të konsiderohet se kontrata është përfunduar pa vullnetin e palëve, nën kërcënim apo nën presion.[...]

41. Në këtë kontekst, Gjykata rithekson se përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për mungesën e arsytimit të vendimit gjyqësor, përkatësisht të Aktgjykimit të kontestuar, Gjykata Supreme (i) kishte sqaruar detajisht në mbështetje të Vendimit të KKPK-së se rrethanat e parashtruesit të kërkesës nuk hyjnë në kompetencën e KKPK-së sepse nuk ndërlihen me periudhën kohore të përcaktuar përmes ligjit të aplikueshëm, përkatësisht 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Gjykata në këtë kontekst gjithashtu thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se ka nënshkruar Kontratën në nëntor të vitit 1999, por është detyruar të shënoj në Kontratë datën e 2 nëntorit 1998, mbështesin të gjeturat dhe konstatimet e Gjykatës Supreme; dhe (ii) kishte trajtuar dhe arsytuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës që ndërlihen me mundësinë e lidhjes së Kontratës përkatëse nën kërcënim, duke i refuzuar të njëjtat bazuar në dëshmitë përkatëse.
42. Prandaj, Gjykata bazuar në sqarimet e mësipërme dhe praktikën gjyqësore të saj dhe atë të GJEDNJ-së konsideron se në rrethanat e rastit konkret pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës përgjatë vendimeve të gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, ishin mjaftueshëm të arsytuara. Në këtë aspekt Gjykata gjithashtu rithekson se gjykatat janë të detyruara të arsyetojnë pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës, por se ky detyrim nuk nënkupton që gjykatat duhet të përgjigjen në secilin argument të parashtruar nga parashtruesit përkatës.

43. Më tej, sa i përket çështjes së administrimit të provave, Gjykata fillimisht thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmëri i 23 tetorit 2017, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 57).
44. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KI06/17, cituar më lart, paragrafi 38; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58).
45. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike ndërlidhen në esencë me pretendimet se ai ka nënshkruar Kontratën nën kërcënim. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se Gjykata Supreme kishte marrë parasysh shkresat e lëndës, në të cilat gjithashtu ishin të përfshira edhe (i) deklarata me numër [8321/99] e 19 tetorit 1999 e vërtetuar në gjykatë në Beograd, përmes të cilës bashkëshortja dhe djali i parashtruesit të kërkesës deklarojnë që janë në pajtim që prona e kontestuar është shitur; (ii) autorizimi [II.nr.8349/99] i 4 nëntorit 1999 i vërtetuar në Gjykatën Komunale në Beograd, i dhënë nga ana e parashtruesit të kërkesës për personin N.V; dhe (iii) Kontrata e shitblerjes [575/2002] e 4 majit 2002, e vërtetuar në Gjykatën Komunale dhe e nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës dhe personi B.K, dhe për pasojë, kishte konstatuar dhe arsyetuar se Kontrata përkatëse e shitblerjes nuk ishte nënshkruar nën kërcënim dhe se rrjedhimisht, rrethanat e rastit konkret nuk hyjnë në fushëveprimin e nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 2007/5.
46. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështet mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

(Shih në këtë kontekst dhe ndër tjerash, rastin e Gjykatës KI49/19, cituar më lart, paragrafi 53).

47. Gjykata gjithashtu thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih rastet e Gjykatës KI118/17, parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 54).
48. Në këtë drejtim, për t'i shmangur keqkuptimet nga ana e parashtrueseve të kërkesës, duhet pasur parasysh se “*drejtësia*” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “*substancial*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës. (Shih gjithashtu rastin e Gjykatës nr. KI42/16 Parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55).
49. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaq*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 56).
- (ii) *Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe neneve 8 e 14 të KEDNJ-së*
50. Në fund dhe përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe neneve 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) e 14 (Ndalimi i diskriminimit) të KEDNJ-së, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të këtyre neneve pa argumentuar dhe arsyetuar shkeljen e të njëjtave përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme. Pretendimet e parashtruesit të kërkesës, në esencë, bazohen në shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, pretendime këto të cilat Gjykata tashmë i shpalli të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
51. Gjykata në këtë aspekt rikujton praktikën e saj gjyqësore sipas së cilës vetëm përmendja e një neni të Kushtetutës, pa arsyetim të qartë dhe adekuat se si është shkelur ajo e drejtë, nuk mjafton si argument për të aktivizuar

makinerinë e mbrojtjes që ofron Kushtetuta dhe Gjykata, si institucion që përkujdeset për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. (Shih, në këtë kontest, rastet e Gjykatës KIo2/18, parashtrues *Qeveria e Republikës së Kosovës [Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor]*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 qershorit 2019, paragrafin 36; KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 tetorit 2019, paragrafët 30-31; dhe KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 52).

52. Një qëndrim i tillë i Gjykatës, është i bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, pretendimet apo ankesat e paarsyetuara dhe të pambështetura me argumente e prova, shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih Udhëzuesin e GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 4. Ankesat e paarsyetuara: mungesa e provave, paragrafët 280 deri më 283).
53. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij për shkelje të neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së dhe për rrjedhojë, këto pretendime duhet të shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
54. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 11 mars 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani
Gresa Caka-Nimani



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi